



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 118/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenice, paraqitur kundër subjektit politik NISMA PER KOSOVEN dega në Kamenice, për shkak të vendosjes së flamurit të subjektit politik NISMA PER KOSOVEN në shtyllat e ndriçimit publik, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë

Arsyetim

PZAP-i, me datën 03.06.2014 ka pranuar një ankesë nga LVV dega Kamenice në të cilën theksohet se me datën 02.06.2014 aktivistët e LVV-së në Kamenice dikur kah ora 12:00 kanë vërejtur se në shtyllën e ndriçimit publik ishte i vendosur flamuri i subjektit politik NISMA. Këto veprime sipas parashtresës të ankesës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregullat Zgjedhore. Parashtresi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografimin nga vendi në të cilin pretendon se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të LVV-së janë të pabazuara pasi që nga fotografia e ofruar si dëshmi shihet qartë se vendi për të cilin pretendon pala ankuese në ankesën e saj është vend i dedikuar për vendosjen e flamujve partiake, andaj mbi këtë bazë ankesa e tillë është e pa bazuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 118/2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*